



# URREJTJA NDAJ FËMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE NË INTERNET!

Raporti i 2-të Kombëtar për Sigurinë në Internet të Fëmijëve dhe të Rinjve në Shqipëri

Tiranë, Shkurt 2020

© Ky botim i **CRCA /ECPAT Shqipëri** mund të citohet, fotokopjohet apo printohet, por gjithnjë duke dhënë referencën përkatëse për autorët dhe organizatën. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të shitet apo botohet pa lejen me shkrim të CRCA Shqipëri. Opinionet, mendimet, pikëpamjet dhe informacioni i dhënë në këtë botim jo detyrimisht shprehin opinionet, pikëpamjet apo qëndrimet e CRCA Shqipëri apo ato të partnerëve tanë.



### Autorë:

**Klaudio PULAHA**

**Altin HAZIZAJ**

### Ekspertë ndihmës:

**Albana Mustafaraj**

**Ervjola Osmanaj**

Referenca e botimit: Pulaha K, Hazizaj A., Raporti i 2-të Kombëtar për sigurinë në internet të fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri, CRCA Shqipëri, 2020.

© Foto, CRCA Shqipëri.

# PËRMBAJTJA

1. **Hyrje:** Situata ndër vite mbi sigurinë e fëmijëve në internet në Shqipëri
2. **Mangësitë që shfaq legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e fëmijëve në internet**
3. Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve nga krimet dhe risqet online, bazuar në **arkitekturën institucionale**
4. **Incidentet e raportuara ndaj fëmijëve dhe të rinjve në internet**
5. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore të raportit

## SHKURTIMET

AKEP      Autoriteti Kombëtar për Komunikimet Elektronike dhe Postare

ALO 116      Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijët në Shqipëri

AMSHDF      Agjensisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve

CRCA      Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri

ISP      Kompani e ofrimit të lidhjes me internetin

## LISTA E GRAFIKËVE

- Grafik 1: Raste të trajtuara në platformën ISIGURT (2016-2019)
- Grafik 2: Shpërndarja e rasteve dhe trajtimit të tyre sipas muajve (2019)
- Grafik 3: Gjinia e fëmijëve
- Grafik 4: Grup-mosha e të ankuarve në Platformë
- Grafik 5: Vendbanimi i fëmijëve sipas qarqeve
- Grafik 6: Platformat, rrjetet dhe faqet për të cilat ka patur ankesa
- Grafik 7: Çështjet kryesore për të cilat ankohen fëmijët
- Grafik 8: Masat e ndërmarra për trajtimin e ankesave përndrejt faqeve / platformave (2019)
- Grafik 9: Referimet e rasteve sipas institucioneve

# 1. Hyrje: Situata ndër vite e sigurisë në internet e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri

Shqipëria shënon prej vitesh një prej vendeve që ka përdorim të gjerë të internetit për të gjitha moshat, përfshirë këtu fëmijët dhe të rinjtë. Rritja e numrit të përdoruesve të internetit në vendin tonë e ka kthyer atë sot në një nga mediumet më të rëndësishme nga njeriu për të komunikuar, mësuar dhe shkëmbyer informacion. Por nga ana tjetër, interneti mbart një sërë rreziqesh për fëmijët, sidomos në drejtim të mbrojtjes së tyre nga dhuna, shfrytëzimi dhe bulizmi online.

Shpesh herë vendet Europiane paraqesin një tablo tjetër, në të cilën grabitqarët seksualë të fëmijëve po i kërkojnë viktimat e tyre në internet. Si shkak i kësaj shumë vende tashmë prej vitesh i janë dedikuar mbrojtjes online të fëmijëve, duke krijuar mekanizma ligjore por edhe shoqërore të mbrojtjes së fëmijëve, duke nxitur denoncimin e faqeve të jashtëligjshme nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër, informimin e vazhdueshëm të prindërve, mësuesve dhe vetë fëmijëve për rreziqet e navigimit në internet.

Shqipëria, edhe pse e re në këtë eksperiencë është duke ndërmarrë hapat e saj të parë në këtë drejtim, ndaj vendi ka ende mangësi në drejtim të mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve gjatë navigimit të tyre online, trajnimit të ligj-zbatuesve për metodat më të fundit të denocimit dhe sigurisë online të fëmijëve dhe informimit të vazhdueshëm të shoqërisë për ta bërë internetin sa më të sigurt për fëmijët.

Ndërkohë, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, i cili duhet të rregullojë fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, për vitin 2019 ende nuk e ka bërë publike Raportin Vjetor 2019. Ndërsa po t'i referohemi të dhënave për vitin 2018, tregojnë se mbi 330 mijë pajtimtarë të lidhur me rrjetin broadband fiks dhe thuajse 2 milionë përdorues të internetit nëpërmjet rrjetit 3G/4G nëpërmjet celularëve në Shqipëri, ose thuajse 70 përqind e popullsisë shqiptare.

Nga ana tjetër, përvoja Europiane sjell eksperiencën se shtetet dhe juristët janë fokusuar te ndërtimi i mekanizmave të fuqishëm të mbrojtjes dhe raportimit të përmbajtjes dhe adresave të paligjshme, ku ka pornografi të fëmijëve apo ku grabitqarët seksualë kërkojnë viktimat e tyre, duke mos neglizhuar edhe dhunën online ndërmjet vetë fëmijëve (bulizmin) ose atë të të rriturve drejt fëmijëve (keqtrajtim / dhunë).

Një vit më parë, CRCA realizoi për herë të parë në Shqipëri një Raport Kombëtar për Sigurinë e Fëmijëve në Internet, duke sjellë realitetin dhe problematikat që has ky fenomen. Raporti i 1-rë Kombëtar për Sigurinë në Internet të Fëmijëve në Shqipëri, tregoi se fëmijët dhe të rinjtë janë plotësisht të pasigurtë dhe të pambrojtur nga Ligji dhe institucionet publike, gjatë përdorimit të internetit.

Sipas Raportit të 1-rë Kombëtar për sigurinë në internet të fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri, përgjatë vitit 2018 situata paraqitej si vijim:

- Djemtë raportojnë në një përqindje më të lartë internet të pasigurt (46%) krahasuar me vajzat që përbënin rreth 43% të fëmijëve që janë ankuar dhe kanë kërkuar ndihmë në platformë.
- Mosha kryesore dhe më e prekur nga dhuna, abuzimi, bulizmi apo vjedhja e identitetit etj. në internet ishte 15-17 vjeç, e ndjekur kjo nga grupmosha 11-14 vjeç.
- Youtube dhe Instagram përbënin dy platformat kryesore të ankesave të fëmijëve dhe adoleshentëve për dhunë, bulizëm, abuzim apo vjedhje të profilit.
- Kategoritë kryesore të shkeljeve që u raportuan gjatë 2018 ishin: gjuha e urrejtjes / mesazhet e urrejtjes përbëjnë ankesën kryesore të fëmijëve dhe adoleshentëve me rreth 62% të rasteve. Në vend të dytë rezultonte hapja e profileve fallco nga kur dikush tjetër pretendon të jetë fëmija që ankohet (15%), e ndjekur nga nuditeti (13%) ose ekspozimi fëmijëve ndaj imazheve erotike apo seksuale.

Situata e sigurisë në internet ka tërhequr edhe interesin e shumë organizatave të tjera për të studiuar këtë problematikë në Shqipëri. Studimi për sigurinë online të fëmijëve në Shqipëri, i realizuar nga World Vision, tregon disa të dhëna shqetësuese, si më poshtë:

- Sipas 44% të të pyeturve, fëmijët shohin materiale pornografike çdo ditë.
- 47% e fëmijëve të intervistuar pranojnë që, brenda vitit të fundit, ata janë kontaktuar online nga një individ i panjohur, ku 40% e tyre ishin kontaktuar nga persona të huaj.
- Të dhënat tregojnë se 62% e fëmijëve që kanë akses në internet kanë një kompjuter në dhomën e tyre të gjumit.
- Ngacmimet (bullying), vjedhja e fjalëkalimeve, si dhe shikimi i paqëllimshëm i materialeve pornografike gjatë përdorimit të internetit janë çështje serioze me të cilat përballen fëmijët aktualisht, ku 45% e të pyeturve vunë në dukje se fëmijëve i duhet të përballen me të tilla çështje çdo ditë.
- 68% e fëmijëve si nga zonat rurale ashtu edhe nga ato urbane konfirmojnë ekzistencën e vendndodhjeve, kompjuterave, ose ekraneve që shfaqin materiale pornografike në kundërshtim me ligjin.
- 32% e fëmijëve të intervistuar konfirmuan që nëse do të lëndoheshin online, më pak të mundshmit për t'iu kërkuar ndihmë do të ishin mësuesit. Kjo pasohej nga policia, ku 27% e fëmijëve nuk e konsiderojnë si një institucion për ndihmë.

Ndërkohë edhe gjatë vitit 2019, duket se u shfaqën dhe vijuan të njëjtat problematika. Shqetësimet dhe raportimet e fëmijëve dhe të rinjve për një internet të pasigurtë, vinin gjithmonë e në rritje. CRCA/ECPAT Shqipëri në bashkëpunim me Platformën Kombëtare ISIGURT.al dhe Child and Youth Policy Hub realizuan edhe Raportin e 2-të vjetor mbi sigurinë e fëmijëve në internet në Shqipëri. Ai përfshin të gjitha statistikat dhe ekspertizën mbi fushat në të cilat fëmijët dhe adoleshentët kanë raportuar pasigurinë e tyre në përdorimin e internetit përgjatë gjithë vitit, duke përfshirë dhe reflektuar të gjitha hallkat ku duhet të punohet për një sistem të sigurt në Shqipëri.



## 2. Mangësitë në legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga rreziqet në internet

Shqipëria në vitet e përdorimit të gjerë të internetit ka ecur së bashku me përmirësime me ritme të shpejta të legjislacionit në drejtim të mbrojtjes së fëmijëve dhe sidomos ai në lidhje me sigurinë kibernetike ka lëvizur ngadalë. Në tërësi mund të thuhet se mbrojtja kryesore që i ofrohet sot fëmijëve vjen nëpërmjet normave të Kodit Penal, ndonëse edhe ato janë të pjesshme dhe nuk ofrojnë një mbrojtje të qartë dhe të plotë të fëmijëve në internet.

CRCA/ECPAT Shqipëri prej vitesh ka punuar dhe falë insistimit të saj, në Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve të vitit 2017, u shtua një nen i posaçëm (Neni 27) për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në materiale me përmbajtje të dëmshme apo të paligjshme në internet, si më poshtë:

### Mbrojtja e fëmijës nga aksesit në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet

- Prindi, kujdestari ose çdo person tjetër, i cili është në kontakt me fëmijën është përgjegjës për të mbrojtur fëmijën nga aksesit në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet.
- Qendrat e ofrimit të internetit, institucionet e edukimit, si dhe çdo institucion tjetër publik ose privat, i cili ofron akses në internet, aplikojnë instrumente teknike dhe masa të tjera për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme, sipas legjislacionit në fuqi.
- Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, kur konstaton se në rrjetet kompjuterike ose ato të informacionit, në faqet e internetit apo në mjedise ku ka fëmijë, qarkullojnë materiale me përmbajtje të dëmshme për fëmijën, sipas këtij ligji dhe ligjit për sigurinë kibernetike, i kërkon autoritetit përgjegjës të marrë masat për bllokimin e aksesit në këto rrjete ose faqe.
- Masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 27 përbën të parën normë juridike në legjislacionin shqiptar që përpiqet të rregullojë dhe japë zgjidhje në lidhje me përmbajtjen e dëmshme në internet, ndërkohë që përmbajtja e paligjshme rregullohet nga Kodi Penal, ndonëse me mangësi të theksuara përse i përket mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna, abuzimi dhe bulizmi në internet.

Nëse do t'i referohemi legjislacionit penal në lidhje me pornografinë dhe shfrytëzimin e fëmijëve (online dhe offline) u përmirësua vetëm pas kërkesave të shoqërisë civile dhe presionit të komunitetit ndërkombëtar (rekmandimit të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës të OKB-së). Nisur nga kjo, gjatë vitit



2016 dhe më pas në vitin 2018, CRCA Shqipëri, në konsultim edhe me Policinë e Shtetit, Prokurorinë e Rrethit Tiranë dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale (tashmë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kërkoi përmirësimin e legjislacionit penal, duke propozuar ndërhyrje dhe shtesa specifike në disa nene të Kodit Penal.

Komisioni i Çështjeve Sociale të Kuvendit organizoi një Seancë Dëgjimore me shoqërinë civile, rreth dy vite më parë, për të marrë mendimet dhe mbështetjen për këto ndryshime. Megjithatë për shkak të krizës politike të vazhdueshme dhe mos-ndjekjes së punimeve të Kuvendit nga opozita për një periudhë 6 mujore, këto ndryshime u lanë mënjanë, për shkak se mungonte kuorumi i nevojshëm për të miratuar këto shtesa të nevojshme në Kodin Penal.

Ndërhyrjet më kryesore të cilat u propozuan nga CRCA Shqipëri për Kuvendin janë:

- **Nenin 117: Pornografia e Fëmijëve**, për shkak të rrezikshmërisë së saj të lartë shoqërore dhe dëmeve që sjell në zhvillimin moral të fëmijëve, kërkon që jo vetëm të dënohet, por nga ana tjetër duhet që të gjitha materialet pornografike të prodhuara, pavarësisht formës apo edhe mënyrës së shpërndarjes, të sekuestrohen dhe asgjесohen. Neni 117 nuk e sqaron këtë aspekt të rëndësishëm, pra se çfarë ndodh me materialet pornografike në përfundim të gjykimit.

- Po në **Nenin 117**, rekomandohet krijimi i Rregjistrit Kombëtar për Krimet Seksuale. Ndërtimi i një politike penale të drejtë për të dënuar, por edhe parandaluar çdo formë të dhunës seksuale ndaj fëmijëve prej të rriturve, si dhe për të rritur sigurinë e fëmijëve dhe publikut, shteti merr masa parandaluese ndaj të gjithë pedofilëve që ata të mos kryejnë krime të tjera seksuale kundër fëmijëve. Për këtë qëllim është e rëndësishme ngritja e një Rregjistri Kombëtar të Krimeve Seksuale.

- Ndryshime thelbësore janë propozuar në **Nenin 124/b**, ku si fillim kërkohet ndarja e dy veprave penale të ndryshme në substancë, asaj të “keqtrajtimit të fëmijës” dhe “të shfrytëzimit të fëmijës”. Komiteti për të Drejtat e Fëmijës të OKB-së në rekomandimet e tij për Shqipërinë në Shtator 2012, kërkonte në mënyrë specifike që shteti palë (Shqipëria) të merrte masa për dënimin e veprave penale të keqtrajtimit, shitjes dhe shfrytëzimit të fëmijëve për punë.

- Përfshirjen në Kod të disa veprave të reja si **Grooming** (përgatitja dhe nxitja e fëmijës për t’u përfshirë në marrëdhënie seksuale), **Sexting** (dërgimi i mesazheve me natyrë seksuale apo erotike fëmijëve), **Ngacmimit seksual të Fëmijëve** nga të rriturit, **mashtrimi ose kërcënimi i të miturit për të kryer marrëdhënie seksuale, përdorimi i paautorizuar dhe vjedhja e identitetit**<sup>1</sup> dhe zgjerimi i kuptimit të normës penale për **”Gjuhën e Urrejtjes”** për të përfshirë edhe fëmijët dhe komunikimet online të tyre, sidomos bulizmin që përdor gjuhën e urrejtjes.

<sup>1</sup> Shtesa e propozuar ne kete veper lidhet dhe shtesen e propozuar ne nenin 284/1 te KPP

### 3. Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga krimet dhe risqet në internet

Pesë vite më parë informacionet mbi raportimet apo edhe ankesat e fëmijëve dhe adoleshentëve për internetin e pasigurt ishin pothuaj zero. Pranë institucioneve shtetërore nuk reflektohej asnjë e dhënë se çfarë ndodhte me ankesat e fëmijëve dhe të rinjve nga interneti i pasigurt. Mungesa e një Linje Hotlin për raportimin e internetit të pasigurt, e bënte tepër të vështirë edhe raportimin nga ana e tyre të materialeve me përmbajtje të parregullt apo dëmtuese, të dhunës, bulizmit, ekspozimit të në gjuhë të urrejtjes etj.

Përgjatë këtyre viteve i vetmi shërbim kombëtar që merrte raportime për këtë çështje, ishte Linja Kombëtare për Ndihmën ndaj Fëmijëve (ALO 161111), por për shkak të kufizimeve ligjore dhe mungesës së politikave që duhet të adresojnë risqet që ndeshin fëmijët në internet, fokusi kryesor ka qenë te materialet me natyrë të paligjshme dhe informimi për rreziqet që mund të ndeshin online fëmijët dhe adoleshentët.

CRCA Shqipëri, me mbështetjen e UNICEF Shqipëri, dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Inovacionit<sup>2</sup>, në vitin 2015 udhëhoqën së bashku një fushatë të gjërë për riorganizimin e të gjithë sistemit të mbrojtjes online të fëmijëve dhe të rinjve. Mungesa e një qasjeje sistemike dhe të organizuar, kërkonte krijimin e një arkitekture të re institucionale për të bërë të mundur trajtimin e duhur dhe trajtimin e mangësive në nivelin e legjislacionit, politikave, institucioneve etj.

Vetëm një vit më vonë, në Shkurt 2016, katër ministritë kryesore të Qeverisë Shqiptare: Ministria e Brendshme, Ministria e Inovacionit, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me shoqërinë civile, në Konferencën e 1-rë Kombëtare “Siguria e Fëmijëve në Internet”, ranë dakord për ndërmarrjen e një sërë masash të përbashkëta për rritjen, forcimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në internet.

Të gjitha institucionet u dakordësuan për këto masa:

- a. Përgatitja e Planit Kombëtar të Veprimit për Sigurinë në Internet;
- b. Propozime Ligjore për përmirësimin e kodit penal dhe ligjeve të tjera për të rritur sigurinë online për fëmijët;
- c. Mbështetjen për krijimin dhe promovimin e Platformës Kombëtare për Sigurinë në Internet [www.ISIGURT.al](http://www.ISIGURT.al);
- d. Fillimi i fushatës kombëtare për informimin e fëmijëve, të rinjve, prindërve dhe mësuesve për risqet dhe rreziqet e internetit. Disa muaj më vonë Shqipëria nënshkroi Deklaratën e Abu Dabit për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimi në internet.

Më poshtë po paraqesim shkurtimisht arkitekturën e re (internet governance) që po krijohet në Shqipëri për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga risqet në internet.

<sup>2</sup> Me ndryshimet që iu bënë strukturës së Qeverisë pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017, kjo Ministri u mbyll dhe përgjegjësitë e saj në lidhje me fëmijët, i kaluan në përgjithësi Ministrisë së re të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

### 3.1 Legjislacioni për mbrojtjen e fëmijëve në internet

Duke ju referuar një prej hallkave kryesore në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në internet, atë të legjislacionit shqiptar për sigurinë në internet, theksojmë se ai paraqet disa mangësi serioze që kërkojnë adresim të shpejtë, në Kodin Penal dhe në Ligjin për Komunikimet Elektronike, për të adresuar çështjen e përmbytjeve të dëmshme dhe të paligjshme dhe përgjegjësitë institucionale që lindin nga këto ndryshime.

Nga ana tjetër duhen vlerësuar ndryshimet që solli Ligji i ri për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në Shqipëri (Ligji 18/2017) dhe roli e përgjegjësitë e reja që i caktohen Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijës nga neni 27 i ligjit. Po në këtë kuadër mbetet për t'u miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave në lidhje me raportimin e përmbajtjes së dëmshme ndaj fëmijëve dhe lëshimin e urdhërit për tërheqjen apo eliminimin e përmbajtjes nga subjektet e ligjit.

### 3.2 Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve në internet



**Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës** është institucioni përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve nën moshën 18 vjeç, së bashku me rrjetin e gjerë të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në nivel vendor. Ligji për Fëmijët i jep të drejtë Agjencisë që për çdo

shkelje të vërejtur të marrë masa ndaj subjekteve fizike ose juridike, shtetërore apo private, dhe sipas rastit të kërkojë ndjekjen penale të tyre, nëse konstatohet kryerja e një vepre penale.



**AKEP – Autoriteti për Komunikimet Elektronike dhe Postare** është rregullatori i të gjithë industrisë së internetit në Shqipëri, i cili në të njëjtën kohë është edhe lëshues i liçensave për kompanitë që duan të ofrojnë shërbime të internetit (ISP-të) apo të telefonisë fikse dhe asaj celulare. Ligji për Komunikimet Elektronike i jep të drejtë AKEP që të kërkojë nga ISP-të dhe kompanitë e telefonisë që të marrin

masa apo raportojnë për shqetësime që kanë të bëjnë me internetin dhe sigurinë e tij, apo kur ka patur dyshime apo është vërtetuar shkelja e ligjit penal, të kërkojë marrjen e masave për bllokimin e subjekteve specifike online, gjetjen e personit etj.



**Policia e Shtetit** është institucioni përgjegjës që garanton mbrojtjen e rendit dhe qytetarëve në Shqipëri, përfshirë edhe fëmijët dhe të rinjtë. Në bashkëpunim dhe nën drejtimin e Prokurorisë, ajo kryen hetime për të gjitha veprat penale që ndodhin ndaj fëmijëve. Pranë saj funksionon një sektor modest për hetimet e krimit kibernetik me specialistë të trajnuar edhe për krimet ndaj fëmijëve.

**Komiteti Këshillues për Sigurinë e Fëmijëve në Internet**, në kuadër të zbatimit të Planit, palët nënshkruese të tij kanë rënë dakord që të ngrenë Komitetin Këshillues për Sigurinë e Fëmijëve në Internet. Komiteti në përbërje të tij do të ketë nga një përfaqësues të çdo Ministrie nënshkruese të Planit, një anëtar nga ASHDMF, Policia e Shtetit, AKEP etj. Anëtar i komitetit mund të jetë çdo organizatë e shoqërisë civile, institucion publik, kompani telekomunikacioni etj. Qëllimi i Komitetit është forcimi i dialogut midis institucioneve shtetërore, shoqërisë civile, industrisë së internetit dhe komunikimit, për sigurinë në internet, me synim krijimin e një rrjeti informal midis të gjithë aktorëve që punojnë dhe kujdesen për mbrojtjen online të fëmijëve.

### 3.3 Politikat publike: Plani Kombëtar për Internet të Sigurt për Fëmijët

Shqipëria edhe prej vitesh ishte një përdoruese e gjerë e internetit dhe moshat e përfshira prekin një masë të konsiderueshme të popullsisë, deri në fillim të vitit 2018, nuk kishte asnjë politikë publike të miratuar për mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve në internet. Në Shkurt të po këtij viti, tre ministrinë kryesore të Qeverisë shqiptare, përgjegjëse për çështjet e fëmijëve: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë dhe Ministria e Brendshme, nënshkruan miratimin e Planit të Veprimit për Sigurinë në Internet të Fëmijëve në Shqipëri.

Ky plan, përveçse ishte një arritje për Shqipërinë sepse e rendiste atë në vendet e pakta në Ballkanin Perëndimor që kanë miratuar plane apo politika publike në mbrojtje të fëmijëve gjatë navigimit të tyre në internet, e shtrin kohën e veprimit të tij ndërmjet viteve 2018-2020.

Plani i Veprimit pati si qëllim:

- Rritjen e sigurisë së fëmijëve gjatë lundrimit të tyre në internet, duke krijuar një platformë të gjerë bashkëpunimi, shkëmbimi dhe koordinimi që bën të mundur rritjen e sigurisë për identifikimin, raportimin dhe kufizimin e aksesit në faqet me përmbajtje të papërshtatshme ose të paligjshme për fëmijët dhe adoleshentët në Shqipëri;
- Forcimin e kuadrit ligjor dhe politikave publike për sigurinë në internet të fëmijëve;
- Mbështetjen e Platformës Kombëtare të Raportimit dhe Informacionit ([www.ISIGURT.AL](http://www.ISIGURT.AL)), e cila u krijon akses fëmijëve, prindërve, mësuesve, grupeve të interesuara, etj, për të raportuar, informuar dhe ndërgjegjësuar mbi sigurinë, rreziqet dhe mënyrat e mbrojtjes nga shfrytëzimi dhe abuzimi online;
- Shkëmbimin e informacionit midis institucioneve, organizatave dhe industrisë së internetit për rritjen e sigurisë në internet të fëmijëve;
- Forcimin e dialogut midis institucioneve shtetërore, shoqërisë civile, industrisë së internetit dhe komunikimit, për të bërë të mundur mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, bulizmi, abuzimi dhe shfrytëzimi në internet;
- Intensifikimin e përpjekjeve në nivel lokal dhe kombëtar për të rritur mbrojtjen dhe sigurinë në internet të fëmijëve;

Plani i Veprimit fokusohet në arritjen e katër objektivave strategjikë:

1. Rritja e sigurisë së fëmijëve në internet nëpërmjet përforcimit të kapaciteteve kombëtare dhe lokale;
2. Forcimi i kuadrit ligjor dhe politikave për sigurinë online të fëmijëve;
3. Forcimi i partneritetit Institucione - OJF – Industri për sigurinë e fëmijëve në internet;

#### 4. Ndërgjegjësimi dhe Informimi për sigurinë online të fëmijëve.

Plani i Veprimit vendos në qendër të vëmendjes përgjegjësinë e përbashkët për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe sigurinë e tyre online të institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile, mësuesve, prindërve, mediave dhe industrisë.

Ky plan kërkon të shërbejë si një udhërrefyes për të caktuar qëllime dhe objektiva strategjike, si dhe bashkërenduar punën dhe veprimtarinë e institucioneve, organizatave, industrisë dhe të gjithë partnerëve socialë të interesuar për sigurinë e fëmijëve në Internet, përgjatë 3 viteve në vijim.

Hapat specifikë që përfshijnë Programi dhe Plani konsistojnë në:

- Përmirësimin e mekanizmave të raportimit nëpërmjet Linjës së Telefonit për Fëmijë ALO 116-111 dhe Platformës Kombëtare të Informacionit për Sigurinë në Internet ([www.ISIGURT.al](http://www.ISIGURT.al)), aplikacioneve në telefon etj;
- Specializimin e punonjësve të fushës, nëpërmjet manualeve dhe trajnimeve të vazhdueshme, duke përfshirë këtu: policinë për kapacitetet investiguese dhe parandaluese, mësuesit për çështjet e informimit dhe psiko-edukimit, punonjësit e njësive për mbrojtjen e fëmijëve për çështjen e trajtimit dhe menaxhimit të rasteve të shfrytëzimit dhe abuzimit online etj;
- Mundësimin e mënyrave dhe mjeteve të aksesit për informimin e fëmijëve mbi abuzimin online, mbrojtjen dhe raportimin e krimeve. Kjo gjë do të mundësohet nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuere.
- Forcimin e bashkëpunimit me sektorin privat, ISP-të kompanitë e telekomunikimit etj.

Plani kombëtar i veprimit synon që të ndërtojë infrastrukturën e nevojshme për të identifikuar viktimat e abuzimit, shfrytëzimit online dhe për të përdorur praktikat më të mira të trajtimit të viktimave të abuzimit dhe shfrytëzimit online; për të ngritur strategji që sigurojnë bashkëpunimin e të gjithë aktorëve socialë në parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri nga abuzimi dhe shfrytëzimi online; për forcimin e legjislacionit që mundëson trajtimin e këtij krimi ligjërisht, kapjen e abuzuesve dhe ndërton mekanizma të mirëfilltë parandalimi dhe trajtimi të viktimave; për t'u siguruar që çdo aktor social ka të drejtën dhe detyrimin për të raportuar rastet e abuzimit dhe materialet me përmbajtje të papërshtatshme për fëmijët.

Paralelisht me Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020 ecën edhe zbatimi i Planit të Veprimit. Një nga objektivat më të rëndësishme të kësaj axhende është fuqizimi i mekanizmave institucionalë qendrorë dhe vendorë për një mjedis elektronik dhe dixhital të sigurt për fëmijët. Ky objektiv përfaqësohet gjerësisht te Plani i Veprimit 2018-2020.

**Lidhur me politikat publike, vlen për t'u theksuar fakti se viti 2020 është përfundimi i disa prej planeve, axhendave dhe strategjive më të rëndësishme që kanë në fokus një internet sa më të sigurt për fëmijët, si Plani i Veprimit 2018-2020 "Mbi internetin e sigurt për fëmijët në Shqipëri", Axhenda Dixhitale 2015-2020, Axhenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020.**

### 3.4 Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve në internet

#### Platforma Kombëtare për Sigurinë e Fëmijëve në Internet (Hotline)



Platforma Kombëtare për Internet të Sigurt u hap zyrtarisht në Tetor 2015, nga CRCA Shqipëri, në faqen e internetit [www.ISIGURT.al](http://www.ISIGURT.al) dhe si aplikacionin për telefonat celularë me të njëjtin emër. Platforma që klasifikohet si një hotline (linjë për raportuar dhe kërkuar ndihmë) është një hapësirë e dedikuar, e cila

shërben si një burim unik informacioni, manualesh, udhëzuesish në lidhje me internetin e sigurt për fëmijët, prindërit, mësuesit, profesionistët që punojnë me/për fëmijët për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi dhe shfrytëzimi online.

Qëllimi i Platformës është të bashkërendojë përpjekjet për të identifikuar dhe për të mbrojtur fëmijët viktimë, për të identifikuar materialet e paligjshme dhe ato me përmbajtje të papërshtatshme për fëmijët në internet, për të informuar prindërit mësuesit, fëmijët etj, si dhe për të forcuar bashkëpunimin ndër-institucional. Misioni kryesor i platformës është raportimi i faqeve me përmbajtje të paligjshme dhe të dëmshme për fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri.

Rubrika **RAPORTO** mbron fëmijët nga abuzimi online, duke marrë, analizuar dhe referuar ankesa nga fëmijët, prindërit, mësuesit, profesionistët që punojnë me/për fëmijët apo çdo person tjetër i interesuar për të raportuar abuzimet online dhe duke i referuar të gjitha ankesave pranë agjensive përkatëse të zbatimit të ligjit dhe institucionet e tjera që ofrojnë shërbime për çështjet e abuzimit online.

#### Linja Kombëtare e Ndhmës për Fëmijët: ALO 116-111



Linja Kombëtare e Telefonit të Ndhmës për Fëmijët – ALO 116 është një shërbim falas këshillimi dhe referimi për fëmijët. Ky shërbim komunikon me fëmijët nëpërmjet numrave: 116111 – Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë dhe ALO 116000 – Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijët e Humbur.

Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijë është një instrument që ka për qëllim të këshillojë fëmijët përmes telefonit dhe të referojë nevojat e tyre në institucionet përkatëse. ALO 116 si një shërbim i ri dhe unik në të gjithë Shqipërinë synon ngritjen e standarteve dhe procedurave të duhuar në funksion të një shërbimi cilësor për fëmijët. Vlerësimi dhe marrja në konsideratë e zërit të fëmijëve nëpërmjet ndërgjegjësimit të të gjithë partnerëve qendrorë dhe lokalë që punojnë me/për fëmijët, është moto e punës së ALO 116.

ALO 116 është një mundësi për çdo fëmijë që të ndihmohet në një moment delikat të jetës së tij/saj. Linja e Këshillimit për Fëmijët është një vend, ku e drejtat e çdo fëmije për t'u dëgjuar, për t'u shprehur, për tu informuar dhe për të informuar mbi situatën e tij/saj respektohet dhe ai/ajo merr shërbimin e duhur, të ofruar nga një staf i kualifikuar.

Shërbimi përqëndrohet te fëmijët në nevojë si: fëmijët e dhunuar, abuzuar apo keqtrajtuar, fëmijët në situatë rruge, fëmijët që shfrytëzohen në punë, fëmijët që janë në konflikt me ligjin etj. Ky shërbim përfshin dhe prindërit, mësuesit, edukatorët apo personat e interesuar për çështje lidhur me dhe për fëmijët. Misioni i ALO 116 është t'u gjendet pranë fëmijëve në momentet e tyre më të vështira, duke mbrojtur dhe avancuar çështjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Ne punojmë që të mbrojmë mirëqenien e fëmijës, nëpërmjet këshillimit me telefon, referimit dhe mbrojtjes pro-aktive të të drejtave të fëmijëve.

## Qendra Kombëtare për Internet të Sigurt në Shqipëri



Qendra Kombëtare për Internet të Sigurt në Shqipëri, ka si mision të saj mundësimin e internetit të sigurt për këdo, sidomos për fëmijët dhe të rinjtë. Ajo punon për rritjen e informimit, ndërgjegjësimit dhe këshillimit të përdoruesve të internetit për rreziqet me të cilat ata përballen online. Qendra do të nxisë krijimin e kulturën e kujdesit, mbrojtjes dhe respektit edhe në botën virtuale.

Qendra ka në përbërje të saj organizata, grupime dhe shërbime kombëtare, si: CRCA Shqipëri, Platformën ISIGURT.AL, Qendrën Kombëtare për Fëmijët e Humbur, Parlamentin Rinor Tiranë, Koalicionin e Arsimit për Fëmijët në Shqipëri dhe Rrjetin Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve. Qendra koordinon shërbimet e saj me Linjën Kombëtare të Telefonit të Ndhmës në Shqipëri, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, Policinë e shtetit dhe industrinë e internetit.

Qendra Kombëtare për Internet të Sigurt në Shqipëri, ka si aktivitete kryesore të saj, sa më poshtë:


- Rritja e ndërgjegjësimit në lidhje me rreziqet e mundshme që hasen gjatë lundrimit online.
- Denoncimi i çdo rasti që vendos në rrezik fëmijët dhe adoleshentët apo i ekspozon ata në materiale të papërshtatshme ose pornografike në platformën [www.ISIGURT.al](http://www.ISIGURT.al) ;
- Ofrimin e këshillave për të qëndruar të sigurt në internet;
- Zhvillimin e legjislacionit, politikave, protokolleve, udhëzuesve dhe praktikave të mira për një internet të sigurt dhe ku çdo person sillet me përgjegjësi dhe respekt për veten dhe të tjerët;
- Zhvillimi i materialeve informative për nxënësit, mësuesit, prindërit dhe mbrojtësit e fëmijëve në Shqipëri, punonjësit e policisë, administratorët dhe punonjësit e industrisë së internetit etj.
- Organizimi i Ditës së Internetit të Sigurt, një nga ngjarjet më të mëdha vjetore ndërkombëtare që zhvillohet gjatë muajit Shkurt, ku Shqipëria merr pjesë që prej vitin 2005. CRCA Shqipëri është organizata e njohur zyrtarisht nga SID për organizimin e aktiviteteve që mbajnë logon e tyre në Shqipëri.
- Organizimi i sesioneve informuese mbi masat që mund të merren për ta bërë internetin sa më të sigurt, por edhe për të mbrojtur fëmijët nga grabitqarët seksualë në internet;
- Forcimin e bashkëpunimit me industrinë e Internetit, të komunikimit dhe AKEP si rregullatori përgjegjës për industrinë e internetit.



## 4. INCIDENTET NË INTERNET NDAJ FËMIJËVE DHE TË RINJVE NË SHQIPËRI

Të dhënat e paraqitura më poshtë janë mbledhur dhe analizuar, bazuar në të dhënat e raportuara në Platformën Kombëtare për Sigurinë në Internet [www.ISIGURT.al](http://www.ISIGURT.al). Ato kanë nisur të mbledhen që prej muajit Tetor 2015 dhe në vijim. Ky raport paraqet në mënyrë sistematike dhe për herë të dytë një analizë të plotë të këtyre të dhënave, me fokus të posaçëm të dhënat për vitin 2019, i cili është viti kryesor i analizës sonë.


### 4.1 Raste të trajtuara nga Platforma ISIGURT.al



Grafiku 1, paraqet numrin e rasteve të trajtuara nga platforma që prej hapjes së saj. Të dhënat për vitin 2015, nuk janë paraqitur, për shkak sepse nuk përbënin një vit të plotë. Pranë platformës ISIGURT.al janë paraqitur më shumë se 300 ankesa, nga të cilat vetëm 240 prej tyre kanë qenë raste që janë vërtetuar të përbëjnë përmbajtje të paligjshme apo të dëmshme për fëmijët.

Gjatë vitit 2019 janë trajtuar 67 raste të fëmijëve dhe të rinjve të referuar në platformën ISIGURT.al dhe 37 raste të tjera të raportuara tek platforma nga referimet e ardhura nga Linja Kombëtare e Ndihmës për Fëmijët-ALO 116-111. Pjesa tjetër e ankesave përbëhen ato që nuk kanë patur meritë, pra që kanë qenë kontakte pa përmbajtje apo thjesht teste të sistemit, nëse funksionon ose jo.

## 4.2 Shpërndarja mujore e rasteve të raportuara dhe të trajtuara në Platformë




Ka një shpërndarje të zhdrejtë të raportimit dhe trajtimit të rasteve gjatë vitit 2019. Sipas të dhënave mund të themi se periudha e dimrit (Nëntor, Dhjetor, Janar) sjell më shumë raportime dhe më shumë raste në Platformë sesa ato gjatë verës, ku rastet ulen ndjeshëm.

Sipas mendimit tonë, kjo lidhet me faktin që në këto muaj fëmijët qëndrojnë për një kohë më të gjatë në mjedise të mbyllura ose në shtëpi dhe kjo nxit përdorimin e internetit, rrjeteve sociale etj., krahasuar me periudhën e verës.

Gjithashtu me nisjen e vitit të ri arsimor, në muajt Shtator, Tetor të vitit 2019, ekspertët e ALO 116 dhe CRCA/ECPAT Shqipëri, organizuan një fushatë intensive ndërgjegjësuese në të 61 bashkitë e vendit me nxënësit e shkollave 9-vjecare dhe të mesme, gjë kjo që rriti ndjeshëm numrin e raportimeve në muajt në vazhdim.

### 4.3 Gjinia e fëmijëve dhe të rinjve që janë ankuar në Platformë

Grafik 3: Gjinia e të ankimuarve




Krahasuar me një vit më parë, përgjatë vitit 2019 ka një ndryshim në balancën e raportimeve midis djemve dhe vajzave. Gjatë vitit 2018 djemtë raportuan në një përqindje më të lartë incidente (46%) krahasuar me vajzat.

Në vitin 2019 shohim një ndryshim të kahut të raportimit më të lartë ku tashmë vajzat raportojnë 55% të incidenteve online, krahasuar me 44% të djemve.

Për rreth 2% të rasteve nuk ka qenë e mundur të përcaktohet gjinia, për shkak të mos deklarimit nga ana e personit që është ankuar. Vlen të thuhet se rreziqet me të cilat përballen fëmijët dhe të rinjtë në internet janë të njëjta, ndonëse duhet thënë se nga të dhënat që zotërojmë, incidentet më të rënda janë raportuar nga vajzat.

### 4.4 Grup-mosha e fëmijëve dhe e të rinjve të prekur nga interneti i pasigurt


Grafik 4: Grup-mosha e të ankuarve në Platformë



Siç shihet edhe nga të dhënat, mosha kryesore dhe më e prekur nga abuzimi, bulizmi apo vjedhja e identitetit etj, në internet është ajo 15-17 vjeç (me 61 raportime) e ndjekur nga persona mbi moshën 18 vjeç (me 20 raste), si dhe me më pak fëmijë të grupmoshës 11-14 vjeç (me 18 raste). Ndërkohë ka patur vetëm një raportim nga fëmijë të grupmoshës 7-10 vjeç si dhe 4 raste nga fëmijë apo persona të cilët nuk kanë deklaruar moshën. Të gjitha raportimet e ardhura pranë Platformës ISIGURT.al janë trajtuar, informuar apo referuar sipas specifikave të rastit.

#### 4.5 Vendbanimi i fëmijëve dhe të rinjve, që kanë raportuar incidente online


Grafik 5: Vendbanimi sipas qarqeve i fëmijëve që raportojnë



Siç shihet edhe nga të dhënat, në tërësi, qytetet më të mëdha mbajnë peshën kryesore të rasteve të raportuara dhe të trajtuara në Platformë. Në këndvështrimin tonë, kur qytetet e vogla raportojnë një numër të lartë të incidenteve, ekziston mundësia që në këto qyteza të ketë një rrjet të organizuar të të rinjve apo të grabitqarëve seksualë që ngacmojnë online adoleshentet vajza, për qëllime të përfitimeve seksuale, një karakteristikë që nuk e kemi gjetur në qytete të mëdha në Shqipëri.

#### 4.6 Platformat, rrjetet dhe faqet për të cilat janë ankuar fëmijët dhe të rinjtë


Grafik 6: Platformat, rrjetet dhe faqet e përfshira në ankesa



Instagram, Youtube dhe Facebook përbëjnë tre platformat kryesore të ankesave të fëmijëve dhe të rinjve për dhunë, bulizëm, abuzim apo vjedhje të profilit. Ashtu siç shihet edhe nga grafiku, ankesat përkundrejt platformave apo faqeve të tjera janë disa herë më të ulta, por përsëri disa prej tyre janë të lidhura me pornografi të fëmijëve, nuditet apo gjuhë urrejtje ndaj fëmijëve dhe të rinjve.

#### 4.7 Format kryesore të dhunës, abuzimit apo shfrytëzimit të fëmijëve në internet


Grafik 7: Çështjet kryesore që raportojnë fëmijët



Gjatë vitit 2019 ndër kategoritë kryesore të incidenteve të raportuara lidhen me gjuhën e urrejtjes, me rreth 38% të rasteve. Në vend të dytë (20%) janë raportimet e kategorizuara si “të tjera” që kanë të bëjnë përgjithësisht me humbje të fjalëkalimit. Në vend të tretë rezultojnë hapja e profileve fallco nga një person tjetër (20%) e ndjekur nga raportimet ku në qendër janë përndjekjet, kërcënimet dhe shantazhimet me rreth 11%, postime të papërshtatshme/nuditet (10%) ose ekspozimi fëmijëve ndaj imazheve erotike apo seksuale. Vetëm në dy raste të referuara pranë Platformës është raportuar për pornografi të fëmijëve, raste të cilat janë referuar pranë Policisë së Shtetit.

#### 4.8 Masat e ndërmarra dhe shkalla e suksesit të trajtimit të rasteve

Grafik 8: Masat e ndërmarra për trajtimin e ankesave përkundrejt faqeve / platformave (2019)




Një ndër qëllimet kryesore të Platformës ISIGURT.al është ndjekja e rasteve të raportuara nga fëmijët dhe të rinjve dhe sipas rastit, nëse ato nuk përbëjnë ndjekje penale, eliminimi i postimeve, kërcënimeve apo bulizmit në internet.

Të dhënat tregojnë se në 51% të rasteve faqet, profilet apo videot e raportuara janë mbyllur, ndërsa rreth 37% e tyre janë ende të hapura apo të aksesueshme online. Po

ashtu një përqindje e vogël përbëjnë (2%) edhe këshillat që i'u janë dhënë fëmijëve dhe të rinjve sesi të veprojnë për të mbyllur profilet e tyre fallco psh apo edhe raste të tjera të ngjashme.

#### 4.9 Referimet e rasteve sipas institucioneve

Grafik 9: Referimet e rasteve sipas institucioneve



Thuajse për të gjitha rastet e ardhura janë njoftuar agjensitë kryesore që janë përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri. Të dhënat nga Platforma tregojnë se thuajse 86% e rasteve janë referuar pranë Agjensisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve (ASHMDF), nga ISIGURT.al apo ALO 116-111, ndërkohë që shtatë raste janë referuar drejt Policisë së Shtetit (raste pornografie, kërcënim dhe përndjekje) dhe shtatë të tjera i janë referuar Facebook për ndjekje të mëtejshme nga ana e tyre.


## 4.10 Shikueshmëria vjetore e Platformës Kombëtare ISIGURT.AL

Platforma Kombëtare (Hotline) [www.ISIGURT.al](http://www.ISIGURT.al) ka marrë përgjatë vitit 2019 rreth 14 mijë vizita në webin e saj, gjë kjo që reflekton jo vetëm gjerësinë në shtrirjen e saj, por edhe mundësinë e madhe që paraqet ajo për të denoncuar incidentet e internetit të pasigurtë nga fëmijët, të rinjtë, prindërit dhe të interesuarit.

Grafiku i mëposhtëm sjell në mënyrë analitike vizitueshmërinë në platformë. Duke ju referuar grafikut, Platforma Kombëtare [www.ISIGURT.al](http://www.ISIGURT.al) merr përafërsisht 2000 vizita në muaj, gjë që tregon se ajo është gjerësisht e vizitueshme nga fëmijët, të rinjtë, mësuesit, prindërit dhe të interesuarit. Po ashtu është pozitiv fakti që ankesat e fëmijëve dhe të rinjve vijnë nga të gjitha qytetet e Shqipërisë, duke treguar se Platforma për shkak të prezencës së saj online dhe në rrjetet sociale është e lehtë për t'u vizituar.

**Grafik 10: Vizitat në Platformën Kombëtare ISIGURT.AL (Viti 2019)**

### Audience Overview





## 5. Gjetjet e raportit dhe rekomandimet kryesore

### 5.1 Gjetjet kryesore

Në përfundim të paraqitjes të të dhënave, po përcjellim gjetjet kryesore të raportit:

- **Në vitin 2019-ta ka një gjashtëfishim të kërcënimeve, shantazhit dhe përndjekjeve** përmes internetit ndaj fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve, një gjetje që nuk është evidentuar më parë nga asnjë raport apo studim në këtë fushë.
- **Çdo tre ditë një fëmijë raporton internet të pasigurt në Shqipëri**, duke ju referuar kështu 104 rasteve të raportuara pranë Platformës ISIGURT.al dhe Linjës Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë ALO 116111.
- Viti 2019, shënoi një rritje të ndjeshme në raportim të vajzave. **55% e raportimeve janë vajzat, krahasuar me 44% djem.** Ndërsa grupmosha më e prekur nga interneti i pasigurt është **15-17 vjeç e ndjekur nga grupmosha mbi 18 vjeç.**
- **Instagram është platforma kryesore, për vitin 2019, për të cilën fëmijët dhe të rinjtë raportojnë pjesën më të madhe të incidenteve online,** të ndjekur nga YouTube dhe Facebook.
- Nga kërkimet e ndryshme rezulton se **nuk ka asnjë raport monitorues dhe aktivitet specifik të realizuar nga institucionet përgjegjëse** për zbatimin e axhendave dhe strategjive si Plani i Veprimit 2018-2020 “Mbi internetin e sigurt për fëmijët në Shqipëri”, Axhenda Dixhitale 2015-2020, Axhenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020, të cilat mbarjonë të gjitha në vitin 2020.
- Në bindjen tonë Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Brëndshme ende **nuk e kanë kuptuar shkallën e problemit të sigurisë online për fëmijët dhe të rinjtë, duke mos patur asnjë zhvillim konkret apo zgjidhje të ofruara gjatw vitit 2019.**
- **Dy javë para publikimit të këtij Raporti, CRCA Shqipëri, në kuadër të Qendrës Kombëtare për Internet të Sigurt, nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me Google,** e cila tashmë zgjeron edhe më tej hapësirat dhe mundësitë e mbrojtjes online të fëmijëve dhe adoleshentëve, sidomos në platformën Youtube. Pjesë e marrëveshjes me Google është edhe trajnimi i stafit të [www.ISIGURT.al](http://www.ISIGURT.al) mbi funksionimin e platformave të Google dhe përdorimit të mekanizmat të saj të raportimit për sigurinë online dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve.
- **Mangësitë në legjislacionin penal shkaktojnë çoroditje tek institucionet ligj-zbatuese,** të cilat përballen me shkeljen e të drejtave të fëmijëve, përfshirë këtu krimet kibernetike

dhe ngacmimet online. Mungesa e parashikimeve dhe rregullimeve ligjore në Kodin Penal e bën tepër të vështirë mbrojtjen online të fëmijëve sidomos nga disa veprime ende të parregulluara si psh: sexting / grooming / child images online / e drejta për t'u harruar / ngacmimi seksual online / bulizmi etj.

- **Institucionet arsimore zhvillojnë një numër tepër të kufizuar aktiviteteve për të ndërgjegjësuar fëmijët dhe adoleshentët mbi rreziqet që ndeshin gjatë lundrimit në internet** dhe mbi mundësitë e ndihmës dhe mbrojtjes që japin Linja Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë ALO 116 111 dhe Platformën Kombëtare ISIGURT.al, duke mos e përmbushur siç duhet qëllimin e tyre të informimit dhe edukimit.
- **Platformat dhe portalet online dhe mediatike shkelin ndjeshëm dhe nuk zbatojnë të drejtat e fëmijëve duke postuar shpesh materiale të papërshtatshme dhe të aksesueshme shumë lehtë nga vetë fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë.** Kompanitë e ndryshme, platformat dhe portalet online, të cilat nga një vëzhgim kanë shumë pak ose aspak promovim dhe hapësira për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë për një internet sa më të sigurt.
- **Gjinia e personit, ndonëse në dukje nuk përbën ndonjë shkak specifik për dhunë, bulizëm apo pornografi në internet, në të vërtetë paraqet disa karakteristika që duhen marrë në konsideratë.** Gjuha e urrejtjes dhe thirrjet për dhunë seksuale në shumicën e rasteve janë të drejtuara ndaj vajzave dhe shumë më rrallë kundër djemve.

## 5.2 Rekomandimet kryesore

Bazuar në të gjitha gjetjet kryesore të këtij raporti dhe duke patur parasysh rëndësinë e madhe që merr vit pas viti siguria në internet, autorët e këtij Raporti rekomandojnë disa zgjidhje, si më poshtë:

### Për Kuvendin e Shqipërisë

- Nisur nga modelet më të fundit të legjislacionit në shtete të ndryshme europiane, del e nevojshme rregullimi jo vetëm në ligjin penal, por edhe hartimi i domosdoshëm i një Ligji të dedikuar posaçërisht mbi mbrojtjen e fëmijëve në internet!
- Në legjislacionin aktual, nenet të cilat mbulojnë gjuhën e urrejtjes kanë nevojë ta adresojnë atë me fokus sidomos gjininë dhe për shumë kategori të tjera të cilat nuk janë të përfshira në to.
- Kuvendi i Shqipërisë, pavarësisht situatave të ndërsa politike me të cilat është përballuar, duhet të gjejë mundësinë që të përfshijë në procedurën e shqyrtimit dhe miratimit parlamentar, ndryshimet dhe shtesat në Kodin Penal të Shqipërisë të propozuara nga CRCA Shqipëri dhe Rrjeti Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve.

### **Për Qeverinë, Ministrinë e linjës dhe institucionet në varësi të saj**

- Institucionet përgjegjëse (MASR, MSHMS, MB) duhet të ndër marrin sa më parë fushata ndërgjegjësuese mbi sigurinë online me fëmijët, duke përfshirë këtu prindërit, mësuesit dhe komunitetin e gjerë. Për këtë qëllim, gjithashtu është urgjente gjetja e qasjeve tërësisht të reja nga ana e institucioneve publike për mbrojtjen e fëmijëve ndaj përmbajtjes dhe sjelljeve të rrezikshme në internet.
- Ministria e Arsimit përpos fushatave, manualeve duhet të organizojë në mënyrë periodike aktivitete me fokus fëmijët dhe mësuesit për të diskutuar mbi masat që mund të merren së bashku për lundrimin e fëmijëve dhe të rinjve sa më të sigurt në internet. Po në këtë kuadër, MARS, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësisë të saj, të marra përsipër në Planin Kombëtar për Internet të Sigurt për Fëmijët në Shqipëri, duhet të mbështesë rrjetet tashmë të organizuara të mësuesve dhe të shoqërisë civile për të forcuar informimin dhe ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe të të rinjve për risqet, por edhe sjelljet e përgjegjshme gjatë navigimit dhe jetës online.
- Institucionet përgjegjëse duhet të nisin sa më parë procesin e konsultimeve për hartimin e axhendave dhe strategjive të reja si Plani i Veprimit 2018-2020 “Mbi internetin e sigurt për fëmijët në Shqipëri”, Axhenda Dixhitale 2015-2020, Axhenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020, të cilat përfundojnë gjatë këtij viti.
- Fuqizimi i fëmijëve dhe të të rinjve për përdorimin me përgjegjësi, respekt dhe në siguri të internetit duhet të jetë një ndër prioritetet kryesore të Ministrisë së Arsimit, Agjencisë së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe shoqërisë civile në Shqipëri. Në këtë kuadër përfshirja e organizatave të fëmijëve dhe të rinjve, si Parlamenti Rinor, Zëri 16+ etj., në edukimin bashkëmoshatar do të ndihmonte në krijimin e një gjenerate të tërë të fëmijëve dhe të rinjve të aftë për të naviguar të sigurt në internet;
- Promovimi i Platformës Kombëtare [www.ISIGURT.al](http://www.ISIGURT.al) është një përgjegjësi e përbashkët e të gjitha institucioneve shtetërore në të gjitha mjediset ku ka fëmijë. Në këtë kuadër në duam të nxisim Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që ta promovojnë Platformën dhe modulën “RAPORTO” në faqet e tyre zyrtare, si dhe në mjediset ku ka fëmijë dhe të rinj, shkolla, qendra shëndetësore, qendra sociale e Rinore etj.

### **Për BE-në, Agjensinë e UN dhe ato të zhvillimit**

- Delegacioni i Bashkimit Europian, Agjensinë e OKB-së, ato të zhvillimit dhe donatorët në tërësi, duhet të mbështesin njëzëri sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në internet, duke mbështetur dhe financuar të vetmen Platformë Kombëtare (ISIGURT.al) që mbron fëmijët dhe të rinjtë nga të gjitha rreziqet online, kjo me qëllim që ata të marrin shërbime të specifikuara për një internet sa më të sigurt.

### Për Industrinë e Internetit

- AKEP së bashku me organizatat e të drejtave të fëmijëve duhet të nisë një dialog sa më të gjerë dhe pozitiv ndërmjet portaleve, organizatave të mediave dhe institucioneve arsimore, për të vendosur një sistem rregullues më të fuqishëm në mënyrë që asnjë portal të mos shkelë të drejtat e fëmijëve.
- Platformat dhe portalet online duhet të marrin në konsideratë mundësinë e nxitjes së bashkëpunimit me Facebook dhe Google lidhur me një internet sa më të sigurt për fëmijët, si dhe të ofrojnë si një pikë kontakti për të gjithë vizitorët fëmijë dhe të rinj, në portalet e tyre platformën ISIGURT.al.
- Liria e fjalës, e shprehjes dhe e drejta e informimit, nuk i përkasin vetëm të rriturve, por edhe fëmijëve dhe të rinjve. Në këtë kuadër të gjitha platformat e lajmeve, të informimit apo argëtimit në gjuhën shqipe dhe me adresë që përfundon me .AL duhet të tregojnë se veprojnë në përputhje dhe në respekt të Ligjit për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në Shqipëri. Ne rekomandojmë që çdo organizatë e medias elektronike në internet të nënshkruajë Kodin e Etikës në Internet ose standarte të kujdesit për fëmijët, që duhet të respektohen nga të gjithë punojësit dhe reporterët e tyre;

### Për shoqërinë civile

- Shoqëria civile luan një rol të pazëvendësueshëm për të informuar fëmijët dhe të rinjtë sesi ata të mbrojnë veten nga dhuna, bulizmi dhe keqtrajtimi. Në këtë aspekt, ne nxisim të gjitha organizatat partnere që të informojnë fëmijët në lidhje me sigurinë në internet dhe Platformën [www.ISIGURT.al](http://www.ISIGURT.al), për të raportuar çdo rast të dyshuar apo të vërtetuar të risqeve online.

## Na kontaktoni

Për më shumë informacion mund të na ndiqni ose shkruani, si më poshtë:

Në web: [www.isigurt.al](http://www.isigurt.al) ose [www.crca.al](http://www.crca.al)

Me email: [isigurt@isigurt.al](mailto:isigurt@isigurt.al)

Me telefon: 116-111

Në rrjete sociale:

ISIGURT: <https://www.facebook.com/I-Sigurt-Online-1678118579105924/>

CRCA: <https://www.facebook.com/crca.al/>